



PRANUAR MË: 15.03.2010
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 01/304



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË



Në mbështetje të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, (Ligji Nr.03/L-040), neni 12,40.2 shkronja (a), Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, (Ligji Nr.03/L-049), neni 10, dhe bazuar në Statutin e Komunës së Malishevës neni 12,19.7 shkronja (e) - Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur, më **05/03/2010**, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E PËR LEJE PUNE KOMUNALE TË VEPRIMTARIVE AFARISTE

I.Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

1.1.Për të krijuar ecuri të rregullt e legale të themelimit të subjekteve afariste, dhe krijimit të ambientit sa më të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarive të tyre,eliminimin e formave jo ligjore, dhe dukurive e kushteve tjera negative në këtë lëmi,ofrim të shërbimeve cilësore për popullatën dhe formimin e inkasimin e drejtë e efektiv të të hyrave për buxhetin e Komunës,miratohet kjo ***Rregullore për Leje Pune Komunale (Licencë)*** të veprimtarive afariste,bizneseve që janë krijuar dhe do të krijohen në Komunën e Malishevës.

1.2.Me këtë Rregullore përcaktohen: kushtet,mënyra dhe procedurat e licencimit komunal të biznesit dhe fushëveprimtaria,përbërja,kompetencat dhe autorizimet e organeve e trupave funksionale të Administratës komunale në këtë lëmi.

Neni 2.

2.1.Emërtimi „subjekt afarist” sipas kësaj Rregulloreje nënkupton secilin subjekt që merret me aktivitete ekonomike të mbështetura në ligj me qëllim përfitimi.

2.2.Të gjitha veprimtaritë afariste ekonomike në komunën e Malishevës duhet të kryhen në vend të caktuar dhe të përshtatshëm për veprimtarinë përkatëse.

Neni 3.

3.1.Asnjë subjekt afarist sipas kësaj Rregulloreje nuk lejohet të ushtrojë veprimtarinë e vet afariste pa Leje Pune Komunale nga organi kompetent i komunës – Drejtoria për Ekonomi,Financa dhe Buxhet.

3.2.Subjekti afarist që ushtron afarizëm në Komunën e Malishevës, duhet të jetë i regjistruar sipas dispozitave të Udhëzimit administrativ për regjistrimin e biznesit nr.2003/1 të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës.

3.3.Leja e punës mund të përdoret vetëm për destinimin e dhënë.

3.4.Subjekti që ushtron veprimtari biznesi brenda Komunës së Malishevës duhet:

- a) për ndërmarrjen amë dhe për secilën njësi (repart,dyqan) të ketë lejen e punës për ushtrimin e biznesit përkatës nga organi kompetent i komunës;
- b) ndërmarrja amë selia e së cilës është në komunën tjetër,për secilën njësi të saj me seli në territorin e Komunës së Malishevës duhet të marrë Leje të punës nga organi i Komunës së Malishevës.

Neni 4.

4.1.Trupi funksional i Administratës komunale (inspektorët komunal), me shikimin e drejtpërdrejtë të ambientit dhe kushteve teknike - sanitare konstatojnë gjendjen me procesverbal që ka të bëjë me të gjitha aspektet e natyrës së veprimtarisë për biznesin që ushtron apo

do ta ushtrojë parashtruesi i kërkesës për Leje pune komunale të biznesit,dhe mbi bazën e këtyre të dhënave do të hartojnë procesverbalin.

4.2.Nëse në rastin e parë konkret konstatohet se janë plotësuar kushtet për licencim,përveç kopjeve tjera,një kopje e procesverbalit e nënshkruar nga të gjithë personat e autorizuar (inspektorët) prezent në proces, i dërgohet Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

4.3.Në rastet kur nga ana e trupit funksional konstatohet se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet për licencim komunal të veprimtarisë së tij,i caktohet një afat tjetër (i dyti apo i tretë) në procesverbal,pas së cilit parashtruesi i kërkesës duhet t'i bëjë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme me qëllim që të krijojë kushte dhe ambient të përshtatshëm për biznes që meriton licencimin komunal.

Neni 5.

5.1.Tarifa për kompenzimin e shërbimit të trupit funksional në rastet e konstatimit të gjendjes dhe aspekteve të veprimtarisë së biznesit për kërkesën e parë është 50 € për çdo biznes,ndërsa në rast të përsëritjes së kërkesës për çdo herë nga 25 €.Tarifa prej 50 € paguhet në dy këste:kësti parë me rastin e bërjes së kërkesës,dhe i dyti me rastin e lëshimit (tërheqjes) të lejes së punës.

5.2.Trupin funksional për konstatim të gjendjes e cakton organi kompetent – Drejtoria për Ekonomi,Financa dhe Buxhet për çdo rast konkret dhe në përbërje adekuate të ekspertëve për veprimtarinë përkatëse.Detyrat dhe kompetencat sipas kësaj Rregulloreje trupit i jepen me urdhëresa dhe autorizime të protokoluara e të parapara sipas procedurave administrative.

II.Paraqitja e kërkesës për licencim komunal

Neni 6.

6.1.Drejtoria për Ekonomi,Financa dhe Buxhet do të përpilojë formularë-kërkesë të një forme standarde për licencim të bizneseve.

6.2.Parashtruesi i kërkesës do ta plotësojë formularin-kërkesë që do të jetë gjithëpërfshirës i informatave të mjaftueshme për parashtruesin e

kërkesës dhe të njëjtin e dorëzon në Zyrën e Pritjes të komunës të adresuar në Drejtorinë për Ekonomi,Financa dhe Buxhet (aty ku edhe merret).

6.3.Kërkesës i bashkëngjitet:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit të ndërmarrjes amë dhe të njërive të saja në pajtim me Udhëzimin administrativ të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë,(certifikata kopje duhet të jetë e vërtetuar);
- Leja e ndërtimit apo shndërrimit të objektit në lokal afarist;
- Dokumenti mbi pronësinë e lokalit afarist ose kontrata për marrjen me qira të vërtetuar nga gjykata kompetente;
- Vërtetimin e pagesës së Tatimit në pronë;
- Vërtetimin për pagesën e mbeturinave;
- Vërtetimin për pagesën e ujit të hargjuar (aty ku është ujësjells i publik)
- Prova e pagesës së tarifës për licencim komunal (sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje).

6.4.Trupi funksional më së largu në afat prej 10 ditësh duhet të bëjë konstatimin e gjendjes dhe të veprorë sipas nenit 4. të kësaj Rregulloreje.

Neni 7.

7.1.Pas konstatimit të gjendjes, Drejtoria për Financa,Ekonomi dhe Buxhet është e obliguar që në afat prej 10 ditësh,prej momentit të pranimit të procesverbalit,parashtruesit të kërkesës t'ia lëshojë aktvendimin – Lejen e Punës me çka i bëhet e ditur se i ka plotësuar kushtet e nevojshme të parapara me Rregullore për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.

7.2.Aktvendimi përkatës në këtë rast është dokumenti përfundimtar, me të cilin subjekti juridik ka fituar të drejtën e Licencimit komunal të biznesit.

7.3. Leja komunale e punës jepet në afat të pacaktuar kohor.

7.4.Leja e punës ka karakter personal dhe nuk mund të bartet në personin tjetër.

7.5.Çdo ndryshim në emërtimin e biznesit,ndërrimin e adresës ose të pronarit që ndodhë pas dorëzimit të kërkesës, apo pas marrjes së Lejes së punës,subjekti afarist është i obliguar ta njoftojë Drejtorinë për Ekonomi,Financa dhe Buxhet për ndryshimet,në afat prej 8 ditësh para se të bëhen ato me kërkesë për evidentimin e tyre.

7.6.Organi kompetent është i obliguar që në afat prej 15 ditësh t'ia japë përgjigjen me shkrim parashtruesit të kërkesës për ndryshimet e propozuara ; t'i lëshoj lejen e re ose të refuzohet kërkesa.

Neni 8.

8.1. Subjekti afarist është i obliguar që në lokalin afarist të ketë:

- lejen e punës të ekspozuar në vend të dukshëm;
- Certifikatën e biznesit nga MTI-Prishtinë;
- të vendosë në vend të dukshëm, ditët dhe orarin e punës, (që duhet të jetë në pajtim me Rregulloren për festat, pushimet ditore dhe javore, ditët e punës dhe fillimin e mbarimin e orarit të punës).

III. Refuzimi i licencimit komunal

Neni 9.

9.1. Kërkesa e subjektit afarist për Leje të punës refuzohet:

- a) nëse biznesit në fjalë nuk i lejohet regjistrimi nga Ministria;
- b) në rast se është konstatuar me procesverbal se ai biznes është në kundërshtim të thellë me ambientin, sigurinë, moralin, qetësinë dhe interesat e qytetarëve të komunës së Malishevës;
- c) nëse me nomenklaturën e vepritarisë së subjektit afarist me rastin e regjistrimit nuk theksohet shprehimisht aktiviteti përkatës i atij lloji;
- ç) nëse parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kërkesave të precizuara, dhe të konstatuara me procesverbal as pas hartimit të procesverbalit të tretë me radhë nga ana e trupit funksional për licencimin komunal të biznesit.

9.2. Ndaj aktvendimit të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet me të cilin refuzohet kërkesa e subjektit për Leje të punës, në afat prej 15 ditësh ekziston e drejta e ankesës në shkallën e dytë. Ankesa duhet drejtuar Kryetarit të Komunës së Malishevës.

IV. Pushimi i vlefshmërisë së Lejes së punës

Neni 10.

Vlefshmëria e Lejes së punës pushon së ekzistuari:

10.1. Në procedurë të rregullt administrative, me kërkesën e subjektit afarist për çregjistrim, me ç'rast dorëzohet Leja e punës;

10.2. Në rast se është lëshuar për veprimtarinë, e cila nuk është e paraparë në nomenklaturën ligjore;

10.3. Me krijimin e rrethanave objektive; vdekja e pronarit, në rast të shkatrrimit të objektit dhe mjeteve të punës, si pasojë e ndodhjes së fuqisë madhore;

10.4. Në rast të mospërmbushjes së obligimeve të taksës komunale ndaj komunës më tepër se një vjet.

V. Autorizimet dhe detyrat

Neni 11.

11.1. Përbërjen konkrete (me emër, mbiemër dhe detyrë) të trupit funksional (ekipit të Inspektorëve), për konstatimin e gjendjes për çdo rast konkret e cakton Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, pas konsultimit me Drejtorin e Inspektoratit, me akt të veçantë juridik.

11.2. Inspektori i tregut :

- Merr urdhëresën përkatëse për detyrat që i parashtrohen ekipit,
- a) njihet me punën e vet dhe plotëson dokumentacionin përkatës, duke marr sa më shumë informata nga evidencat e organit për rastin që do të procedohet;
- b) kërkon certifikatën mbi regjistrimin e biznesit dhe vendosjen e saj në vend të dukshëm;
- ç) kërkon vendosjen e mbishkrimit të subjektit afarist;
- c) nga subjekti kërkon ta dëshmojë kryerjen e obligimeve sipas rregulloreve komunale me aktvendimet tjera;
- d) teston njësitë matëse mbi shitjen e mallrave, a janë standarde dhe të testuara;
- e) kërkesat tjera që dalin në fushën e veprimtarisë së tij nga rregulloret dhe dispozitat tjera përkatëse ligjore.

11.3. Inspektori sanitar :

- a) kërkon certifikimin mbi mallrat ushqimore;
- b) vendosja dhe shitja e tyre, a i përshtatet kushteve higjieniko-sanitare;
- c) a posedojnë të gjithë punëtorët librezën sanitare,uniformën (veshjen) përkatëse të profesionit;
- ç) kontrollon burimin dhe cilësitë e analizave të ujit që përdoret,dhe se kyçja në nyjet sanitare, a është sipas rregullave legale;
- d) kontrollon afatet e skadimit për mallrat ushqimore,dhe medikamenteve tjera mjekuese dhe bujqësore;
- e) kujdeset që legalizimi i një biznes të tillë,nuk është në kundërshtim me normat ligjore, rregulloret dhe standardet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit;
- f) a posedon subjekti pajisje shëndetësore për dhënien e ndihmës së parë në rastet e lëndimit në punë,dhe
- g) kërkesat tjera që dalin në fushën e veprimtarisë së tij nga rregulloret dhe dispozitat tjera përkatëse ligjore.

11.4. Inspekrori i punës :

- a) kërkon plotësimin e procedurave dhe standardeve sipas dispozitave ligjore mbi marrëdhëniet e punës për të gjithë të punësuarit në subjekt,
- b) a respektohet dhe a është vendosur orari i punës në vend të dukshëm dhe, a i përgjigjet rregulloreve komunale mbi orarin e punës dhe pushimet ditore,javore dhe vjetore;
- c) kërkon pajisjet që kanë të bëjnë me sigurinë në punë,pajisjet kundër zjarrit,helmetat sidomos te guroret dhe pajisjet tjera të nevojshme për veprimtarinë përkatëse,

11.5.Personi i autorizuar për çështje kadastrale dhe të pronësisë:

- a) kërkon fletëposedimin dhe kopjen e planit për ngastrën përkatëse;
- b) kontratën mbi qiranë (me saktësi vlerën e qirasë);
- c) vërteton se janë bërë të gjitha pagesat dhe detyrimet tjera të parapara me rregulloret komunale,dhe kërkesat tjera që dalin nga dispozitat e aplikueshme,

11.6. Inspektori i ndërtimit:

- a) kërkon lejen ndërtimore;
- b) vërteton se ndërtimi i objektit i përgjigjet rregullave dhe standardeve të pranueshme për veprimtarinë përkatëse ;
- c) se ndërtimet nuk e pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe mallrave;
- ç) se kyçjet në rrjetë janë bërë sipas standardeve të ndërtimit të ulët dhe të lartë;
- d) kërkesat tjera që dalin nga dispozitat dhe rregulloret e aplikueshme mbi ndërtimin.

11.4. Inspektori i bujqësisë :

- a) me rastin e licencimit të barnatoreve, barnatoreve bujqësore, kooperativave, fermave dhe në përgjithësi të agrobizneseve, konstaton se veprimtaria e tyre nuk është në kundërshtim me rregullat dhe parimet themelore të ushtrimit të veprimtarisë bujqësore, blegtorale dhe të shpezëtarisë;
- b) konstaton se produktet bujqësore dhe blegtorale nuk i janë ekspozuar ndonjë rreziku nga sëmundjet dhe dëmtuesit e mundshëm;
- c) se origjina e këtyre produkteve, barërat dhe farërat i përgjigjet certifikimit dhe dokumentacionit përkatës të prezantuar dhe të pranuar;
- ç) për licencimin e fermave konstaton se kushtet e ushqimit dhe të ambientit për kafshët dhe shtazët në përgjithësi janë të pranueshme dhe u përgjigjen standardeve,
- d) objekti, hapësira dhe ambienti i plotësojnë kushtet lidhur me atë veprimtari, sidomos vendosja e plehrave dhe materieve kimike e të helmueshme;
- e) konstaton se në ato hapsira afariste nuk shitet apo përgatitet edhe ushqim për njerëz në të njëjtën hapësirë apo lokal;
- f) kërkesa tjera që dalin nga dispozitat dhe rregulloret përkatëse për këtë veprimtari.

11.5. Inspektori për shërbime publike :

- a) konstaton se kyçja në sistemet e rrjetit të energjetikës, ujësjellësit, kanalizimit, telefonisë, hedhjes së mbeturinave dhe rrugëve a është bërë sipas standardeve të pranura dhe rregullave të aplikueshme;
- b) kërkon kryerjen e detyrimeve financiare dhe tjera sipas

- rregulloreve komunale mbi shërbimet publike;
- c) parashtron rregullat për respektimin e linjave të transportit të udhëtarëve;
- ç) rregullon çështje të transportit të mallrave dhe shërbimeve;
- d) kërkesa tjera që dalin nga dispozitat dhe rregulloret përkatëse për këtë lëmi.

VI. Dispozitat ndëshkuese

Neni 12.

12.1. Secili subjekt afarist që është i krijuar dhe ushtron veprimtarinë dhe ato që do të krijohen në të ardhmen dhe plotësojnë kushtet sipas nenit 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje është i obliguar që të bëjë kërkesë për lëshimin e Lejes për punë në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 13.

13.1. Subjekti afarist që edhe pas vërejtjes së dhënë me procesverbal nga Inspektoret gjendet pa regjistrim të subjektit afarist, apo pa Leje të punës komunale në afatin prej 7 ditësh sipas kësaj Rregulloreje do të bëhet mbyllja e veprimtarisë afariste (lokalit) nga Drejtoria e Inspektoratit deri në plotësimin e kushteve (neni 3 dhe 5 i kësaj Rregulloreje) në afat prej 10 ditësh pas mbylljes dhe në rast të mos plotësimit të kushteve lënda, do të dërgohet në gjykatë dhe masat ndëshkuese do të jenë të shqiptuara nga Gjykata për kundërvajtje:

- a) Përsone Juridik (Subjektin afarist) 500-1000 € ;
- b) Përsone Fizik (personi përgjegjës i subj. afar) 250-500 €.

13.2. Subjekti afarist (personi përgjegjës), që edhe pas vërejtjes së dhënë me procesverbal nga Inspektorët ushtron veprimtarinë afariste pa regjistrim të subjektit afarist, apo pa Leje të Punës Komunale në afatin prej 7 ditëve, personi përgjegjës ka bërë kundërvajtje dhe lënda do të procedohet për Gjykatën Kundërvajtëse dhe do të dënohet nga Gjykata për kundërvajtje .

- c) Personin Juridik (Subjektin afarist) 600-1000 €.
- d) Personin Fizik (personi përgjegjës i subj. afar) 300-500 €.
- e) Tregtarët ambulator (lëvizës) 100-300 €.

13.3.Nëse gjendet personi përgjegjës që pas mbylljes së veprimtarisë afariste e ka rihap prapë pa Lejen e Drejtorisë së Inspektoratit,atëherë do të behet konfiskimi i mallit dhe lënda do të shkoj ne Gjykatën kompetente për rihapje të jashtëligjshme të veprimtarisë afariste dhe dënimet nga gjykata do të jenë dyfishi i shumës se paraparë në nenin 13.1

13.4 Malli i konfiskuar do të deponohet në një depo, ku e parasheh si të nevojshme Drejtoria e Inspektoratit për ruajtjen e tij dhe, i njëjti mall do të shitet përmes Ankandit Publik.

Mjetet financiare të fituara nga shitja e mallit nga Ankandi publik janë të hyra të jashtëzakonshme për buxhetin komunal.

13.5. Subjekti afarist, i cili vepron në kundërshtim me nenin 3.3 do t'i tërhiqet vërejtja me shkrim në afatin prej 5 ditësh dhe pas kalimit të afatit kohor bëhet përsëritja e veprimit nga personi përgjegjës konsiderohet se ka bërë kundërvajtje dhe do të paraqitet kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Gjykatën kompetente për ushtrim jolegal të veprimtarisë afariste kurse dënimet qe do t'i shqiptohen nga Gjykata do të jenë si në nenin 13.2 te kësaj Rregulloreje.

13.4. Subjekti afarist i cili vepron në kundërshtim me nenin 3.4 (a,b) do t'i tërhiqet vërejtja me shkrim që në afatin kohor prej 7 ditëve ta regjistrojë njësinë, dhe të pajiset me Leje pune.

13.5.Nëse edhe pas caktimit të afatit kohor, nuk e bën regjistrimin e njësisë punuese për Leje pune, ka shkaktuar kundërvajtje dhe do të paraqitet kërkesë për dënim dhe me këtë rast do të dënohet nga Gjykata kundërvajtëse sikurse ne nenin 13.2 te kësaj Rregulloreje.

13.6. Përsoni përgjegjës i subjektit afarist nëse, vepron në kundërshtim të nenit 8 te kësaj Rregulloreje ka bërë kundërvajtje, dhe njëkohësisht do të paraqitet kërkesa për dënim në Gjykatën kundërvajtëse, e cila do ta dënojë përsonin përgjegjës të subjektit afarist shumën prej 100 €.

13.7.Të hyrat e krijuara nga dispozitat ndëshkuese të kësaj Rregulloreje janë të hyra të buxhetit të Komunës së Malishevës.

VII. *Dispozitat kalimtare*

Neni 14.

Implementimin e kësaj Rregulloreje e bën Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, Drejtoria e Inspektoratit.

Neni 15.

Organi komunal kompetent është i obliguar që në afat prej 10 ditësh, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të marr aktvendim për formën e Lejes së Punës Komunale (licencës), formën dhe përmbajtjen e formularit – kërkesës për licencim.

Neni 16

Asnjëra nga dispozitat e kësaj Rregulloreje komunale nuk do të ndalojë cilin do person apo subjekt të goditur nga këto kushte për të kërkuar dëmshpërblim nga një institucion apo Gjykatë kompetente.

Neni 17.

Me miratimin e kësaj Rregulloreje bie nga fuqia Rregullorja nr.01/879 e datës 30/10/2003 si dhe Ndryshimet dhe Plotësimet e së njëjtës Rregullore.

Neni 18.

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 01/ 304

Datë 15 / 03 2010

Kryesuesi i Kuvendit

